Në bazë të Kreut IX, nenit 53 të Statutit të FGJK-së, Bordi i FGJK-së miratoj këtë:

RREGULLORE TEKNIKE MBI ORGANIZIMIN E GARAVE TË FGJK-SË

PREZENTIMI,

Rregullorja Teknike e FGJK-së, përfshinë rregullat dhe llojet e mëposhtme:

- Gjimnastikës Artistikë për femra dhe meshkuj,
- Gjimnastikës Ritmike,
- Gjimnastrada,

Kjo rregullore teknike e FGJK-së, është në përputhje dhe e përshtatur me Rregulloret Teknike të Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës (FIG).
Në rast të ndonjë konflikti kuptimorë të çdo dispozite dhe neni të kësaj rregullore do të mbizotrojnë ndryshimet përkatëse.
Rregullorja teknike aktuale zbatohet për garat kombëtare dhe ndërkombëtare në Gjimnastikë të mbajtura në Republikën e Kosovës.
Rendi i përparësisë për garat në këtë Rregullore do të jetë si më poshtë:

- Kampionati i Kosovës,
- Kupa e Kosovës,
- Liga A,
- Liga B,
- Gjimnastrada dhe ngjarje të tjera.

NENI 1.

QËLLIMI DHE EFEKTI JURIDIK I KËSAJ RREGULLORE

Artikulli 1.1. QËLLIMI

Qëllimi i Rregullorës Teknike aktuale është të sigurojë një mjet zyrtar për kontrollin, organizimin dhe funksionimin e kërkesave teknike të FGJK-së, në të gjitha fushat e gjimnastikës që konstaton në sigurimin dhe nxitjen e zhvillimit të gjithanshëm.

Artikulli 1.2. EFEKTI JURIDIK

Efekti juridik i kësaj Rregullore aktuale e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës bazohet në Statutin e FGJK-së, Kreu IX, Neni 53.

Arikulli 1.3. FUSHËVEPRIMI

Rregullorja aktuale zbatohet për të gjithë anëtarët e FGJK-së, të gjitha klubet, shoqatat që janë nën ombrellën e FGJK-së, dhe insitucione të ndryshme të tjera që bashkëpunojnë me FGJK-në.

Artikulli 1.4. NORMAT, PARIMET DHE RREGULLAT UDHËZUESE PËR LLOJET E GARAVE GJIMNASTIKORE,

Të gjithë anëtarët, klubet, shoqatat, dhe institucione tjera të FGJK-së, duhet të sigurojnë pajtueshmëri me këtë Rregullore teknike në lidhje me pjesëmarrjen në garat e FGJK-së dhe/ose organizimin e garave të FGJK-së. Rregullat dhe llojet e garave gjimnastikore të zhvilluara nga Komiteti Teknik i FGJK-së, dhe të miratuara nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, njashu dhe vlerësimin, kombinimin dhe struktura e lëvizjeve, pikët e zbritura për lëvizjet e kryera gabimisht, rregullat nga trajnerët, gjimnasti, dhe gjyqtarët, duke përfshi masat disiplinore për shkeljet, si dhe detaje të organizimit dhe menaxhimit të garave.

NENI 2.

GARAT ZYRTARE TË FGJK-SË,

Artikulli 2.1. GARAT ZYRTARE

Detajet e fazes së kualifikimit, pjesëmarrësit në garë, arbitrimi, kërkesat organizative dhe të tjera janë të përmendura në këtë Rregullore**.**

Artikulli 2.2. NIVELI A, NIVELI B, PËR GJIMNASTIKË ARTISKE PËR MESHKUJ DHE FEMRA

Garat e NIVELI A, në gjimnastikën artistike për femra dhe meshkuj, zhvillohen duke ju referuar planit dhe kalendarit të garave të miratuara nga Kuvendi dhe Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.
Në garat e NIVELI A, pjesëmarrës janë të gjithë gjimnastet/tët (në tekstin e radhës atletë), të grupmoshave dhe kategori të ndryshme në gjithsej gjashtë (6) kategori, gjithmonë duke ju referuar tabelës së grupmoshave e cila është aktuale për një vit kalendarik.

Viti i Lindjës	Mosha 01 Janar 31 Djetor 2022	Kategoria
2016	6	Para Yllka / Fatos
2015	7	
2014	8	
2013	9	Yllka / Fatos
2012	10	
2011	11	Para Pioniere / Pionier
2010	12	
2009	13	Pioniere / Pionier
2008	14	
2007	15	Juniore / Junior
2006	16	
2005	17	Seniore / Senior
2004	18	
2003	19	

Në këtë Nivel pjesëmarrës janë atletë elitar, të klubeve të regjistruara në FGJK, ku çdo klub ka të drejtën e regjistrimit të atletëve femra dhe meshkuj mirëpo jo më shumë se tre (3) për gara individuale dhe jo më pak së gjashtë (6) për gara ekipore.
Në gjimnastikën artistike për femra dhe meshkuj, zhvillohen duke ju referuar planit dhe kalendarit të garave të miratuara nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.
Në garat e NIVELIT B, pjesëmarrës janë të gjithë gjimnastet/tët (në tekstin e radhës atletë), të grupmoshave dhe kategori të ndryshme në gjithsej gjashtë (6) kategori, gjithmonë duke ju referuar tabelës së grupmoshave e cila është aktuale për një vit kalendarik.
Në këtë Nivel, pjesëmarrës janë atletë të klubeve të regjistruara në FGJK, ku çdo klub ka të drejtën e regjistrimit të atletëve femra dhe meshkuj me numër të pakufizuar. Çdo klub që regjistron atletët në gara të FGJK-së, është i obliguar që të paguaj shumën nga pesë (5) euro për një pjesëmarrës.

Artikulli 2.3. KAMPIONATI I KOSOVËS

Duke u bazuar në statut, FGJK është organizata përgjegjëse për organizimin dhe mbajtjen e garave të gjimnastikës në Republikën e Kosovës.
Kampionati i Kosovës në gjimnastikë artistike për mëshkuj dhe femra, është garë zyrtare që mbahet për gjashtë (6) kategori, dhe mbahet njëher në vit.
Atletët që plotësojnë kërkesat e përmendura në artikulllin 5.1. të kësaj rregullore, dhe rregullores se regjistrimit dhe transferit të gjimnastve, dhe vendosen në grupmoshat e përmendura në artikullin 5.2. dhe tabelës së grupmoshave të FGJK-së, kanë të drejtë të marrin pjesë në këto gara.
Kategori të ndryshme atletësh në varësi të llojit të garës së gjimnastikës/performancës në garat kualifikuese/kryesore përcaktohet me anë të shortit. Kjo përcaktohet sipas rregullave përkatëse ose shortit të kryer nga kryetrajneri. Në varësi të numrit të pjesëmarrësve, numri i atletëve pjesëmarrës në finale mund të ndryshohet me vendim të kryetrajnerit të llojit përkatës të garave gjimnastikore.

Artikulli 2.4. KUPA E KOSOVËS NË GJIMNASTIKË ARTISTIKE PËR FEMRA DHE MESHKUJ

Duke u bazuar në statut, FGJK është organizata përgjegjëse për organizimin dhe mbajtjen e garave të gjimnastikës në Republikën e Kosovës.
Kampionati i Kosovës në gjimnastikë artistike për mëshkuj dhe femra, është garë zyrtare që mbahet për tetë (8) kategori, dhe mbahet njëher në vit.
Atletët që plotësojnë kërkesat e përmendura në artikulllin 5.1. të kësaj rregullore, dhe rregullores se regjistrimit dhe transferit të gjimnastve, dhe vendosen në grupmoshat e përmendura në artikullin 5.2. dhe tabelës së grupmoshave të FGJK-së, kanë të drejtë të marrin pjesë në këto gara.
Kategori të ndryshme atletësh në varësi të llojit të garës së gjimnastikës/performancës në garat kualifikuese/kryesore përcaktohet me anë të shortit. Kjo përcaktohet sipas rregullave përkatëse ose shortit të kryer nga kryetrajneri. Në varësi të numrit të pjesëmarrësve, numri i atletëve pjesëmarrës në finale mund të ndryshohet me vendim të kryetrajnerit të llojit përkatës të garave gjimnastikore.
Programi i garave të NIVELI – A, NIVELI – B, KAMPONATIT TË KOSOVËS, KUPËS SË KOSOVËS në gjimnastikës artistike për meshkuj dhe femra mbahen në përputhje me:

Meshkuj
Për të gjithë (all-around) ekipore
Duke performuar në 6 vegla,
Përjashtim kanë kapërcimet që janë dy tentime,
Finalja Individuale në vegla: 1 përformacë në çdo vegël, përjashtim kapërcimet kanë dy tentime.

Femra
Për të gjithë (all-around) ekipore
Duke përformuar në 4 vegla,
Përjashtim kanë kapërcimet që janë dy tentime,
Finalja Individuale në vegla: 1 përformacë në çdo vegël, përjashtim kapërcimet kanë dy tentime.

Sekuenca e daljeve në vegla kryhet në rendin e më poshtëm:

MESHKUJ
Parteri, (lëvizjet e lira, performancë)
Kali për Kapërcime,
Hekuri Gjimnastikorë,
Pralelet e Meshkujve,
Kali me Doreza,
Unazat Gjimnastikore

FEMRA
Parteri, (lëvizjet e lira, perfomancë)
Kali për kapërcime,
Trau gjimnastikorë,
Paralelet asimetrike (shkalëzuara),

Në varësi të formatit të garave, komisioni i garave me miratim të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, mund të propozojë ndryshime në formatin e garës, numrin e pjesëmarrësve, grupmoshave, afatet për regjistrim, dhe elemente të tjera organizative të garës të cilat i publikohen apo ju komunikohen klubeve, gjithashtu propozon që të modifikoj lartësin e veglave gjimnastikore, dhe përbërjen e lëvizjeve dhe kombinimin e performancës në parter.
Tek përfomanca e Kalit për kapërcime, atletët duhet të ekzekutojnë dy (2) herë, lëvizje të ndryshme, dhe rezultati kualifikues llogaritet në bazë të mesatarës së pikëve për dy (2) ekzekutimet. Nëse atleti gjat vrapimit nuk kërcen nga pedana mirëpo prek veglën, atëherë llogaritet si ekzekutim i pare, dhe nëse vrapon dhe nuk prek veglën, ka të drejtën e ekzekutimit prap dy (2) herë.
Garat gjithëpërfshirëse janë të gjithanshme dhe me grumbullimin e pikëve në veglat përkatëse përcaktohet fituesi.
Tetë (8) atletët më të mirë bazuar në rezultate e veglave individuale të garave kryesore gjithëpërfshirëse do të garojnë për finale të veglave. Finalet e veglave individuale përcaktojnë fituesin dhe atleti me më së shumti pikë shpallet fitues i veglës përkatëse.

Artikulli 2.5. GJIMNASTIKA RITMIKE,

Programi i garave të gjimnastikës ritmike të FGJK-së mund të organizohet në formatin e mëposhtëm në përputhje me rregullat e FGJK-së, dhe FIG.

- Garat Kryesore që përcaktojnë listën e renditjes në garën e individuale dhe ekipore,
- Finalet e atleteve individualë / ekipeve të gjimnastikës në grup dhe vegla të veçanta.

Një atletë/ekip, gjatë ushtrimeve kryen një (1) përformancë në çdo vegël/program për të cilin kualifikohen për në finale.
Përformancat e atletëve/ekipeve janë:

- Veglat (e aplikueshme vetë për grupmoshat e vogla), LITARI (përveç atleteve individuale në grupmoshat e moshuara).
- Fjongo,
- Topi,
- Birila,
- Rreth,
- Litarë, etj.

Atletet në përformanca individuale zakonisht kryejnë 4 paraqitje, dhe ekipet e gjimnastikës në grup kryejnë 2 paraqitje.
Program për performancë të painstrumentuar edhe në finalet e klasifikimit / gjithëpërfshirës dhe të instrumenteve individuale. Një grup i plotë me litar, rrathë, top, shkopinj dhe fiongo, mund të përdoret nga atletët gjatë kur performojnë individualisht në varësi të grupmoshës së tyre .
Çdo klub mund të regjistrojë minimumi 5 dhe maksimumi 6 atlete për programin e përgjithshëm të lëvizjeve në grup (2 gara dhe 2 finale). Emrat e gjimnastëve në grup kur janë të regjistruar 6 gjimnastësh:

- 2 dalje të programit,
- mund të regjistrohet si gjimnast rezervë për një shfaqje të programit dhe për një shfaqje tjetër.

Në varësi të grupmoshës, çdo lëvizje në grup duhet të kryhet nga 4, 5 ose 6 atlete. Ngjarjet kryesore përcaktojnë fituesit e gjithanshëm duke grumbulluar pikë për veglat përkatëse. Garat kryesore përcaktojnë fituesit në renditjen e ekipeve bazuar në pikët e grumbulluara. Tetë (8) atlete më të mira / ekipet, bazuar në rezultatet e kualifikimit për veglën e futur në program, zgjidhen për të marrë pjesë në finalet për veglat individuale.
Sipas rezultateve të garës kryesore , caktohen tre (3) atlete rezervë në ekipore. Kur thirret për të marrë pjesë, atletja rezerviste performon sipas radhës së performancës së gjimnastit zëvendësues.
Finalet individuale të veglave përcaktojnë atletën fituese në çdo vegël. Atletja me më shumë pikë shpallet fitues i veglës përkatëse.
Asnjë atlete individuale ose ekipore nuk mund të përsërisë performancën e saj, përveç në rrethana të paparashikuara jashtë kontrollit të atletës dhe me miratimin e Gjyqtarit kryesor.

Artikulli 2.6. GJIMNASTRADA E KOSOVËS,

Kjo lloj gare është garë që organizohet nga FGJK me vendim të Bordit Ekzekutive, dhe duke ju referuar rregullave të FGJK-së, FIG dhe EG. Gara mbahet në ambiente të mbyllura, mirëpo mund të mbahet edhe në ambiente të hapura. Numri i performuesve nuk është i kufizuar. Gara është ekipore, ku secili grup duhet të ketë ekipin minimum nga 3 atletë. Pjesëmarrje kanë të drejtë të gjitha gupmoshat, pa dallim gjinie. Performanca duhet të përfshijë: pjesën muzikale (me ose pa tekst), koreografi (kërcim) dhe ushtrime akrobatike. Kohezgjatja e përformancës është nga 1 minut e 30 sekonda deri 2 minuta e 15 sekonda. Lejohet përdordimi i pajisjeve gjimnastikore si: top, birila, fjongo, rreth, litarë, etj. Çdo ekip duhet të ketë veshje të njejtë, klubet e regjistruara kanë të drejtë të prezentohen vetëm me një përformancë, dhe se gjyqtaria vlerëson, koordinimin, ritmikën, dhe harmonin ekipore.

Artikulli 2.7. NGJARJE TË TJERA

Kampionati, Kupa, Ritmike, Gjimnastrada dhe garat ndërkombëtare mund të zhvillohen për çdo lloj gare gjimnastikore, me vendim të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, në pajtueshmëri me ligjin e sportit dhe rregullave tjera të aplikuara në vend.

NENI 3.

ORARI I GARAVE

Si pjesë e planit të marketingut, të gjitha garat gjimnastikore duhet të fillojnë jo më herët se ora 12:00 dhe të përfundojnë jo më vonë se ora 22:00, në mënyrë që popullata e Kosovës të mësohet me këtë kohë.

Artikul 3.1. GARAT E ORGANIZUARA NGA KLUBET NË BASHKËPUNIM ME FGJK

Çdo klub ka të drejtë të organizojë gara gjimnastikore. Klubet që dëshirojnë dhe kanë mundësi të organizimit të një garë të brendshme ose me pjesëmarrje të 3 apo 4 klubeve tjera, mund ta bejnë këtë mirëpo paraprkisht njoftojnë anëtarët e FGJK (bordin). Prandaj është tërësisht në kompetenca të çdo klubi, shoqate organizimi i garave që mundësojnë zhvillimin e gjimnastikës dhe marrrëdhënjeve miqësore në vend, në pajtueshmëri më këtë rregullore. Organizmi i garave bëhet nga po i njejti rend.

- Koha dhe vendi i garës,
- Programi i garës,
- Përcaktimi i fituesit/sve,
- Protokoli i garave dhe ceremonive të ndarjes së çmimeve.

Klubi, shoqatat duhet ti ndjekin me përpikëri pikat e lartë përmendura. Nëse është e nevojshme, numri i gjyqtarëve mund të ndryshohet nga organizatori. Të gjitha çështjet dhe detajet e tjera organizative dhe teknike duhet t'u komunikohen pjesëmarrësve me shkrim.
Për t'iu përshtatur nevojave specifike të garës, me pëlqim të FGJK lejohen edhe ndryshime.

Artikulli 3.2. GARAT NDËRKOMBËTARE,

Përveç garave të lartë përmendura, të gjitha garat ndërkombëtare në gjimnastikë të organizuara në territorin e Republikës së Kosovës mund të zhvillohen me miratimin e FGJK-së, duke marrë parasysh këtë rregullore, ligjin e sportit të Republikës së Kosovës, rregullat e FIG, MKRS, KOK, MPB, MPJ të Republikës së Kosovës.
Miratimi për garë duhet të mirret të paktën dy muaj përpara mbajtjes së këtyre garave.

NENI 4.

ORGANIZIMI I GARAVE

Artikulli 4.1. PJESËMARRJA NË KAMPINATET E KOSOVËS DHE RREGULLI I REGJISTRIMIT

Formularët për regjistrim të klubeve në kampionate i dërgon FGJK, dhe se klubet janë të obliguara për t'i plotësuar.
Formulari (tabela) e regjistrimit për garat (duhet të plotësohet në mënyrë elektronike) dhe të dërgohet tek komisioni i garave të FGJK-së dy jave para gare, ky formular (tabelë) mund të dërgohet fizikisht, dhe me anë të postës elektronike. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe klubet obligohen që për atletet e tyre të regjistruara në garë të e dërgojnë muzikën përmes postës elektronike tek komisioni për regjistrim të garave i FGJK-së, e cila është pjesë e përfomancës së tyre, (muzika në gjimnastikë artistike për femra duhet të jetë pa tekst, vetëm instrumental). Formulari i regjistrimit duket si në tabelën 1.

NR.	EMRI MBIEMRI	KLUBI	VITI I LINDJES	PARTER		KAPËRCIME		TRAU	PARALELE SHKALLËZUAR	PARALELE MESHKUJ	KALI ME DOREZA	HEKUR
				FEMRA	MESHKUJ	FEMRA	MESHKUJ					
1				☑	☐	☑	☐	☐	☐	☐	☐	☐
2				☑	☐	☑	☐	☐	☐	☐	☐	☐
3				☑	☐	☑	☐	☐	☐	☐	☐	☐
4				☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
5				☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
6				☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐

Tabela 1.

Çdo klub që dëshiron të marr pjesë në gara duhet të dorëzojë dokumentet, muzikën e cekura më lartë dhe të plotësuara saktësisht në data e përcaktuara, ndryshe klubet dhe shoqatat që nuk i plotësojnë kushtet, nuk do të mund të marrin pjesë në gara.

Artikulli 4.2. NDRYSHIMET NË LISTA PËRFUNDIMTARE

Pas përfudnimit të afatit të dorëzimit të formularit (tabelës) së regjistrimit, listës së pjesëmarrësve nuk mund t'i shtohet asnjë emër. Nëse për ndonjë arsye të justifikueshme, atleti mund të hiqet nga lista e pjesëmarrësve. Në raste të jashtëzakonshme me vendim të komisionit garues mund të bëhet ndryshimi në listën përfundimtare.

Artikulli 4.3. PROJEKT RREGULLORJA,

Shorti para garës do të kryeht sipas kësaj renditje:

- Shorti do të kryhet në prezencë të kryetrajnerëve, dhe atë brenda një jave nga data e regjistrimit,
- Hedhja e shortit kryhet fizikisht ose me anë të kompjuterit nga kryetari i komisionit garues,
- Shorti përcakton radhën e atletëve dhe përformancën e tyre në çdo kategori.
- Për shëndetin dhe sigurinë e atletëve, do të përkujdeset ekipi mjekësorë, dhe atletët që marrin pjesë në finale do t'u duhen 10 minuta kohë për t'u rikuperuar përpara së të performojnë përsëri, varësisht nga lloji i lëndimit.

Artikulli 4.4. ORGANIZATORI

Për të organizuar gara të caktuara FGJK është përgjegjëse dhe merr përsipër të sigurojë mbajtjen e garave pa të meta, në sallat që plotësojnë kriteret e organizimit në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore, dhe rregulloreve tjera të FGJK-së.

Artikulli 4.5. PËRFAQËSUESIT DHE ORGANIZATORËT NË MBLEDHJE PARA GARAVE

Komisioni i garave i FGJK-së, duhet që t'i ftoj përfaqësuesit e klubeve dhe shoqatave të paraqitura për garë, trajnerëve dhe gjyqtarëve në mbledhje para gare, dhe atë një (1) javë para gare.

Artikulli 4.6. ADMINISTRIMI I GARAVE

Të gjitha garat menaxhohen nga FGJK. Të gjitha vendimet e nevojshme për mbarëvajtjen e garave merren nga Komisioni i garave si dhe nga Bordi Ekzekutiv.

Artikulli 4.7. PARTNERËT KYÇ TË EMËRUAR NGA ORGANIZATORI.

Me miratimin e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, përcaktohen punonjësit kryesorë.

a. Përsoni kyç (Drejtori) në krye me organizmin e garave, ky përson menaxhon të gjithë personelin e përfshirë për të punuar në vendin e garave dhe mbikqyrë punën e tyre. Ai duhet të ketë njohuri teknike përkatëse të gjimnastikës, ku në këtë proces hynë edhe vullnetarët.
b. Shefi i Shërbimit të Furnizimit, ky punonjës emërohet nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, dhe është i lidhur ngusht me Drejtorin. Shefi i shërbimit të furnizimit është përgjegjës për vendosjen e veglave në vendin e garave, furnizimin e pajisjeve të nevojshme, shtrirjen dhe sigurinë e sallës, si dhe zbatimin e punëve tjera administrative që lidhen me zhvillimin e garave në tërësi.
c. Përgjegjsi i Shërbimit të Llogaritjes së Pikëve gjatë garave, llogaritja e pikëve në garat zyrtare të FGJK-së, për momentin kryhet nga programi i përpunuar (softëare) nga kryetari i gjyqtarëve të FGJK-së, mirëpo mund të kryhet edhe nga një kompani llogaritëse në bazë të një kontrate të nënshkruar paraprakisht me FGJK-në. Gjatë organizimit të garave gjimnastikore, përfaqësuesi i emëruar ofron shërbime në fushën e zhvillimit dhe zbatimit të sistemit elektronik të pikëzimit dhe gjyqtarisë, përcaktimin e kohës (matjen). Pas përformimit të një gjimnasti, pikët duhet që të dalin në tabelën elektronike të vendosur në sallë, dhe me kjartësi për lexim nga të gjithë shikuesit.

Artikulli 4.8. PROGRAMI I PËRGJITHSHËM

Programi i garave duhet të zhvillohet në detaje, në bashkëpunim të ngushtë më Kryetrajnerin/Përfaqësuesin e Përfaqësuesës dhe të miratohet nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së. Kryetrajneri/ Përfaqësuesi është përgjegjës për përgatitjen e planit për gara dhe stërvitje të Përfaqësuesës.

Artikulli 4.9. PALESTRA (SALLA) E GARAVE.

Palestra e garave nuk duhet të dëmtojë reputacionin e garave të organizuara nga FGJK. Në thelb, numri i vendeve minimale për shikuesit nuk duhet të jetë më pak se 50 vende.
Temperatura në palestër duhet të jetë 28 gradë ose më poshtë e cila përcaktohet në raport me temperaturën dhe lagështinë.
Përveç palestrës kryesore, duhet të jetë edhe një palestër/sallë e përshtatshme dhe e pajisur që i mundëson atletëve të bëjnë nxemje para garës, e që salla duhet të jetë afër ose ngjitur sallës kryesore, në mënyrë që atletët pas nxemjes të kenë çasje direkte në sallën kryesore, dhe se kjo zonë për nxemje të atletëve është e destinuar vetëm për pjesëmarrësit e garave.
Nëse shkaktohet ndonjë dëm në vegla gjimnastikore, dysheme si rezultat i pirjes së ndonjë pije (çaj, kafe, etj), ose ngrënjes së ushqimit në sallën kryesore dhe të nxemjes, kosotja e dëmit do të kërkohet të paguhet nga përfaqësuesi përkatës i klubit. Distanca midis veglave gjimnastikore është shumë e rëndësishme për të siguruar sigurinë e duhur të pjesëmarrsëve në gjimnastikë artistike.

Në gjimnastikë Ritmike, lartësia e sallës duhet të jetë së paku tetë (8) metra, Sipërfaqja e punës duhet të jetë 13m x 13 (jashtë vijës) dhe duhet të ketë një zonë sigurie, (e mbuluar me tapet), me gjërësi të paktën 50cm përgjatë skajit të zonës së tapetit.

Artikulli 4.10. PAJISJET NË GJIMNASTIKË

Për të siguruar shoqërimin e përformancës dhe lëvizjet e lira në, Gjimnastikës artistike për femra, gjimnastikë ritmike dhe gjimnastratë, pajisjet që plotësojnë standaradet e vendosura, duke përfshirë pajisjet elektronike muzikore, amplikuesit e zërit, pajisjen numëruese decibel dhe pajisjet të tjera të nevojshme, duhet të instalohen dhe mbahen në gjendjë pune. Në të gjitha pajisjet dhe veglat gjimnastikore do të ushtrohet inspektimi para gare.

Artikulli 4.11. KËRKESAT E JURIDIKSIONIT

Organizatori, gjegjësisht drejtori së bashku me komisionin garues, duhet që t'i marrin masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e përfshirë në procesin e gjykimit (gjyqtarët) të ulen në tavolinat e destinuara për gjyqtarë.

Artikulli 4.12. MUZIKA

Frekuenca e zërit (muzika dhe njoftimet) nuk duhet të jetë më e lartë se 80 decibel (dB), në 1000 Hertz (Hz). Inspektimi/kontrolli duhet të kryhet nga personeli i shërbimit të furnizimit teknik të garave, si dhe nga personel të kualifikuar. Mbajtja e nivelit të zërit brenda kufijve të sipërpërmendur është përgjegjësi e teknikut përgjegjës. Ai nuk duhet të lëjojë asnjë kërkesë dhe ndërhyrje nga pjesëmarrësit e garave dhe dhe njërëzit tjerë përreth.
Prezentimi i muzikës kryhet sipas rregullave të FGJK-së, dhe rregullave të FIG. Muzika duhet të dorëzohet nga pjesëmarrësit e garave tek komisioni garues nëpërmjet CD, USB, ose përmes postës elektronike në formatin mp3 e shkarkuar më parë në kualitet të lartë, dhe se është përgjegjësi e trajnerit për dërgesë të muzikës. Garuesit që nuk paraqesin muzikën në kohë nuk lejohen që të marrin pjesë në garë dhe nëse gjatë garës konstatohet se muzika nuk i përket performancës si rezultat i papërgjegjësisë, atëherë garuesja largohet nga gara. Gjithashtu garuesti duhet të kenë parasysh ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfërta LIGJI Nr. 04/L-065, të Republikës së Kosovës.

4.13. GJYKIMI (ARBITRIMI) – PIKËT DHE RAPORTIMI

Pikët e dhëna nga secili gjyqtar duhet të regjistrohen dhe të transportohen në sistem të pikëzimit. Për çdo përformancë, pikët totale të çdo paneli gjyqtarësh, penalltitë (zbritja e pikëve), rezultati përfundimtar për performancën dhe vendi i atletëve kryhen sipas rregullave të FGJK-së për të gjitha llojet e gjimnastikës.
Në gjimnastikë artistike për femra dhe mëshkuj, paneli i gjyqatarëve përbëhet nga:

- Gjyqtari kryesor,
- Panli E i cili merret me zbritje të pikëve, dhe përbëhet nga minimum 3 gjyqatarë,
- Paneli D i cili merret me vështirësi, dhe përbëhet nga minimumi 2 gjyqtare,

Varësisht nga gara nëse është e nevojshme numri i gjyqtarëve në përbërje mund të ndryshohet.

4.14. PALESTRA / SALLA E STËRVITJEVE

Salla e stërvitjeve duhet të sigurohet për stërvitje para garës. Sipas vendimit të Bordit Ekzekutiv, salla e stërvitjeve për garuesit duhet të jetë në dispozicion të atletëve të paktën një (1) ditë para fillimi të garave.
Të zbatohet kontrolli i nevojshmë mbi përdorimin e veglave në sallë të stërvitjes dhe të lejohet vetëm për pjesëmarrësit dhe trajnerët e tyre gjatë sesionit stërvitor, duke caktuar një plan dhe orar në të cilin ekipet pjesëmarrëse nuk do i pengojnë njëra tjetrës gjatë stërvitjeve.
Nuk lejohet që gjatë stërvitjeve të përdoret ushqimi apo pije (çaj, kafe, etj), në rast të ndonjë dëmtimi në vegla ose dysheme si rezultat i përdorimit të ushqimit dhe pijeve, kostoja e dëmit do të kërkohet të paguhet nga përfaqësuesi përkatës. Në sallë pjesëmarrësit mund të përdorin vetëm ujë.
Regjistrimi i videos për çfardo qëllimi është i ndaluar në sallën e trajnimit pa pëlqim të kryetrajnerit të klubit.

Artikulli 4.15. NGROHJA (NXEMJA) E ATLETËVE

Nxemja duhet të kryhet sipas rregullave të FGJK-së në garë. Nëse është ë nevojshme, këto rregulla mund të modifikohen nga Komisioni i garave dhe bordit ekzekutiv të FGJK-së, sipas formatit të garave.

Artikulli 4.16. VEGLAT GJIMNASTIKORE

Veglat gjimnastikore të shrytëzuara (përdorura) në gara të organizuara nga FGJK, duhet të çerfitikohen nga FIG.

Artikulli 4.17. STAFI I GARAVE

Një numër i mjaftueshëm, vullnetarësh, asistentësh mund të punësohen nga zyrët e garës për të siguruar mbarëvajtjen efikase të garës, që përfshinë:

- personat që i përcjellin gjimnastët duke performuar individualisht dhe në çdo kategori në tapet - një anëtarë për çdo panel gjyqtarësh dhe në pajisjet dhe veglat e vendosura për gjyqtarët,
- një teknik mbikëqyrës,
- një teknik për pajisjet informatike,
- përgjegjës për instalimin e mjeteve dhe ndërhyrjen sa herë që është e nevojshme,
- ekipi që vendos podiumin për ceremonitë zyrtare dhe ndihmon në realizimin e këtyre ceremonive,
- një person që kontrollon licencat e sportistëve, trajnerëve dhe gjyqtarëve,
- personi që mbikëqyr reklamat dhe promovimet e veshjeve sportive,
- personat që mbikëqyrin përgatitjen e atletëve përpara hyrjes në sallë,
- roje sigurie që kontrollojnë audiencën - person që kontrollon mjetet / pajisjet
- nëse është e nevojshme, gjyqtarët e linjës dhe gjyqtarët e kohës,
- Personi që rregullon hyrjen e atletëve që performojnë individualisht dhe çdo kategori në sallën e garave.
- Mjeku, fizioterapist dhe personeli tjetër i nevojshëm,
- Vullnetarët,

Të gjithë personat e lartpërmendur duhet të jenë të trajnuar mirë dhe plotësisht të janë të ndërgjegjshëm në kryerjen e detyrave të tyre.

4.18. SHËRBIMET MJEKËSORE,

Është e rëndësishme të gjate garave të jetë një dhomë mjekësore e pajisur siç duhet me personel mjekësor.
Një shërbim efektiv i ndihmës së parë emergjente duhet të ofrohet në vendin e ngjarjes (përfshirë zonat e garës, stërvitjes dhe nxemjes).
Çdo sëmundje ose dëmtim gjatë garës duhet t'i raportohet menjëherë stafit mjekësor nga trajneri ose drejtuesi i grupit të punës.
I dëmtuari ose i sëmurë (ose personat) duhet t'i nënshtrohen një ekzaminimi mjekësor dhe një mendim përkatës me shkrim për lëndimin (sëmundjen) duhet të jepet nga ekipi mjekësor.

Neni 4.19. KUSHTET PËR MEDIA

Pas marrëveshjes me menaxhmentin e FGJK-së, caktohet anëtari i shtypit dhe / osë personi ndërlidhës i FGJK-së për bashkëpunim me mediat vendore. Këta përsona u ofrojnë përfaqësuesve të mediave kushte efektive dhe mjaft të favorshme.

Artikulli 4.20. HYRJA NË ZONËN E GARAVE

Në zonën e garave i lejohet të hynë, anëtarët e panelit të gjyqtarëve, pjesëmarrësit e garës dhe trajnerët e tyre zyrtarë, përsonat që i përcjellin atletët në tapet, përsoneli mjekësor, përsonat përgjegjës për inspektimin e veglave dhe pajisjeve tjera përcjellëse. Numri i trajnerëve nga çdo klub nuk duhet të kalojë numrin e gjimnastëve, gjithashtu numri i trajnerëve nga çdo klub nuk duhet të kalojë 2 trajner. Përsonave të tjerë u ndalohet rreptësisht hyrja në zonën e garave.
Vërejtje: trajnërët duhet të kënë kartelë të vlefshme (akreditimi) stërvitore nga FGJK për të hyrë në zonën e garave.

Artikulli 4.21. PALESTRA / SALLA E GARAVE

Në sallë ku zhvillohen garat gjimnastikore, nuk lejohet përdorimi i sinjalit fotografik (flash) gjatë fotografimit dhe gjatë garave, sidomos kur atletët janë duke përformuar, si dhe realizimi i video inçizimeve komerciale pa leje paraprake zyrtare.
Siguria në zonën e garës duhet të jetë e lartë për zhvillim të mirëfillt të garës, duhet të respektohen kërkesat e punonjësve të shërbimit dukë përfshirë informacionin e dhënë në njoftime.

Artikulli 4.22. MASAT E SIGURISË

Delegacionet e klubeve, shoqatave, mysafirëve gjatë garave zyrtarë të FGJK-së, (përfshirë pjesëmarrësit në garë, trajnerët, gjyqtarët, zyrtarët dhe personat e tjerë të përfëshirë në garë), duhet të jenë të sigurtë, me anë të garantimit të sigurisë. Asnjë shikues nuk do të këtë të mundur futjen në zonën e garës, dhe zonat tjera operative që lidhen me garën. Personeli i sigurisë duhet të marr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që mbarvatja e garës të shkoj në mënyrë të sigurtë.

Artikulli 4.23. MBLEDHJA E DOKUMENTEVE

Komisioni i garave në mes të informacioneve tjera, do të marrë informacionin e mëposhtëm nga çdo klub pjesëmarrës përpara garës, (në momentin e akreditimit në FGJK), ose në kohën e përcaktuar sipas rregullave përkatëse.

- Refuzimi për të marr pjesë në fazat përfundimtare (nëse është e nevojshme),
- Leja për të modifikuar veglat gjimnastikore, 24 orë para fillimit të garës.

NENI 5.

MBIKËQYRJA E ATLETËVE

Artikulli 5.1. TË DREJTAT KRYESORE PËR PJESËMARRËSIT NË GARË DHE LIÇENCAT

Në garat zyrtare të FGJK-së,

- Të regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës, duke respektuar statutin dhe rregulloret e FGJK-së,
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, (Vërejtje: përsonat pa shtetësi të Republikës së Kosovës duhet të paraqesin një dokument që konfirmon qëndrimin e tyre të ligjshëm në vend, duke u bazuar në rregulloren e FGJK-së, për regjistrimin dhe transferin e atleteve.
- Të ketë liçencë ose formular regjistrimi gjimnastikorë të vlefshme dhe të lëshuar nga FGJK,
- Nëse janë garat ndërkombëtare liçencë të lëshuar nga FIG.

Artikulli 5.2. MOSHA E PJESËMARRËSVE

Mosha e pjesëmarrsëve në garat e FGJK-së, të destinuara për kategorinë e moshës madhore në vitin e garave përkatëse duhet të jetë si më poshtë:

GJIMNASTIKË ARTISTIKE PËR FEMRA

KATEGORITË	MOSHA
Para – Yllka	6 – 7 – 8 vjeçe
Yllka	9 – 10 vjeçe
Para-Pioniere	11 – 12 vjeçe
Pioniere	13 – 14 vjeçe
Juniore	15 – 16 vjeçe
Seniore	17 vjeçe lartë

GJIMNASTIKË ARTISTIKE PËR MESHKUJ

KATEGORITË	MOSHA
Para – Fatos	6 – 7 - 8 vjeç
Fatos	9 – 10 vjeç
Para – Pionier	11 – 12 vjeç
Pionier	13 – 14 vjeç
Junir	15 – 17 vjeç
Senior	18 vjeç lartë

GJIMNASTIKË RITMIKE

KATEGORITË	MOSHA
Yllka	8 vjeçe
Para - Pioniere	8 – 10 vjeçe
Pioniere	11 – 12 vjeçe
Juniore	13 – 16 vjeçe
Seniore	17 vjeçe e lartë

Artikulli 5.3. SHOQËRIMI I ATLETËVE NGA TRAJNERËT E TYRE

Për t'u regjistruar si trajner në garat zyrtare të FGJK-së dhe për të pasur të drejtën e shoqërimit të atletëve në terren, trajnerët duhet të kenë kartën e vlefshme të trajnerit të lëshuar nga FGJK, e cila vërteton se ata kanë përfunduar me sukses stërvitjen e përbashkët dhe kurset e anti-dopingut të organizuara nga FIG dhe FGJK. Një trajnerë i pa regjistruar dhe i pa akredituar nga FGJK, dhe nuk njihet nga federata, ai/ata nuk mund të

shoqërojnë atletët si trajnerë në sallën e stërvitjes/nxemejes dhe në fushën e garave, gjatë garave kombëtare të organizuara dhe të njohura nga FGJK, dhe nuk do mund të marr pjesë si trajnerë në asnjë garë ndërkombëtare.

Artikulli 5.4. RREGULLAT E PËRGJITSHME TË SJELLJES

Sjellje të pahijshme të atletëve në gara, veprime që degradojnë dinjitetin njerëzor me pretekst të kryerjes së abuzimeve racore, seksuale, fetare, etnike etj. në rast të diskriminimit në terren, duke përfshirë shkeljen e dispozitave të rregullore së Kodit etik të sjelljes së Trajnerit, Atletëve të FGJK-së, dhe rregullave antidoping të FGJK-së, FIG, KosADA, WADA, të gjitha këto çështje do t'i paraqiten dhe shqyrtohen nga Komisioni Disiplinor dhe mund të zbatohet ndëshkimi sipas asaj sjelljeje.
Rregullat e FGJK-së, për disiplinën përkatëse të gjimnastikës përmbajnë edhe çështje të tjera që lidhen me mbarëvajtjen e garave dhe kontrollin e garave.
Gjatë gjithë garës, atletëve, gjyqtarëve dhe trajnerëve u ndalohet rreptësisht përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera elektronike të komunikimit.

Artikulli 5.5. HYRJA DALJA NË ZONËN GARUESE

Dalje e paautorizuar nga vendi i garues dhe sanksionet e aplikueshme, nëse një atlet, grup ose ekip largohet nga gara, kjo mund të bëhet vetëm me rëkomandim të mjekut zyrtar të garës, nëse atleti nuk është në gjendje të sigurojë një certifikatë mjekësore, atleti, grup ose ekip diskualifikohet nga gara dhe nuk lejohet të vazhdojë të marrë pjesë në garë.
Pikët që kanë grumbulluar deri më tani do të llogariten dhe do të gjejnë vendin e tyre në renditje sipas radhës.
Dalja e paautorizuar nga vendi i garës dhe sanksionet e zbatueshme kryhen në përputhje me Kodin Disiplinor të FGJK-së, në varësi të llojeve të garës.

Artikulli 5.6. NDIHMA E TRAJNERËVE,

Trajneri i gjimnastikës artistike të meshkujve gjatë garës nuk ka të dretë të paraqitet në:
- dysheme,
- kali për kapërcime,
- kali me doreza,
- paralele të meshkujve,

Ndërsa në gjimnastikë artistike të femrave trajneri nuk ka të drejtë të paraqitet dhe asistoj (ndihmoj) në:
- dysheme,
- traun gjimnastikorë,
- kalin për kapërcime,

Trajneri i gjimnastikës artistike për meshkuj është i obliguar për t'i qëndruar atletit të tij afër kur ai performon në:
- Hekurin gjimnastikorë,
- Unazat,

Trajneri i gjimnastikës artistike për femra është i obliguar për t'i qëndruar atletit afër kur ajo performon në:
- Paralelen asimterike (shkallëzuar),

Çdo mos zabtim i këtyre kritereve e penalizon atletin/atleten, dhe paneli i gjyqtarisë është përgjegjës për këtë.

Artikulli 5.7. VESHJA E GARUESVE GJATË GARAVE

Në gjimnastikën artistike për meshkuj, veshja e garuesëve nësë është eikp atëherë i gjithë ekipi duhet të ketë veshjen e njejtë. Meshkujt kur performojnë në dysheme dhe në kapërcime janë të obliguar që të kenë të veshur leotard (maicë) dhe shorce, kurse kur performojnë në vegla tjera gjimnastikore janë të obliguar që të kenë të veshur leotard (maicë) dhe të poshtmet t'i ken të gjata.
Meshkujve nuk u lejohet të performojnë nëse nuk i kanë dorezat gjimnastikore të cilat janë për Hekur gjimnastikorë dhe Unaza. Nëse për ndonjë arsye atleti duhet të vendos fasho në këmbë atëherë ai duhet që të vendos fasho me ngjyrë njeriu, ngjyra tjera nuk lejohen. Nuk lejohet që atleti të perfomoj me veshje të ndonjë sporti tjetër.
Në gjimnastikë artistike për femra, veshja e garuesëve nëse është ekip atëherë duhet i gjithë ekipi duhet të ketë veshjen e njëjtë. Femrat gjatë performimit në të gjitha veglat duhet të kenë të veshur leotard (triko), **por mund të** kenë të veshur triko komplete sipas rregullave të FIG. Njashtu femrat nese nuk i kanë dorezat gjimnastikore, nuk mund të performojnë në paralelen astimetrike.
Femrat duhet që flokët t'i kenë të lidhura, dhe vathët, zinxhirët, etj, nuk lejohen gjatë performimit.
Në garat ndërkombëtare dhe vendore, i tërë klubi/ekipi duhet të ketë veshje të njejtë gjimnastikore, me logo ose emblemë që tregon se cilit klub apo ekipit i takon (përfaqëson). Logoja ose emblema duhet të vendosen në veshje duke rrespektuar rregullat standarde, dimensionet, anën etj.

NENI 6.

GJYQTARIA NË GARA

Artikulli 6.1. PARIMET E PËRGJITHSHME

Të gjitha paraqitjet në garat gjimnastikore duhe të vlerësohen nga gjyqtarët që kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer këtë funksion. Ata duhet të vlerësojnë saktë levizjet, përformancën e kryer nga atletët dhe të jenë fer në vlerëim.

Artikulli 6.2. FITIMI I TË DREJTËS PËR TË GJYQTAR NË GARAT ZYRTARE TË FGJK-SË

Për t'u angazhuar në aktivitetet e gjyqtarisë të përmendur në pikën 7.8, është e nevojshme që të jenë në fuqi kategoritë përkatëse të trajnimit dhe gjyqatarisë në FGJK-së.
Në mënyrë që një përson të jetë gjyqtar në garat zyrtare të FGJK-së, duhet të trajnohet e pastaj të kaloj provimin. Gjyqtarët duhet që trajnimet t'i përcjellin kur vendi është i disponueshëm në FIG, dhe të çertifikohen me BREVET lëshuar nga FIG, dhe se me këtë çertifikat gjyqtari mund të gjykoj edhe në garat ndërkobëtare, mirëpo nëse është i çertifikuar nga Gjimnastika Europiane atëher nuk mund të gjykoj në garat e organizuara nga FIG.
FGJK nuk ka gjyqtar të çertifikuar me BREVET, mirëpo ka panelin e gjyqtarisë E, dhe D, për garat e organizuara nga FGJK në nivel vendi, dhe trajnim për gjyqtar të rinjë për gjimnastikë artistike për femra dhe meshkuj.

Artikulli 6.3. TRAJNIMI PËR TË MARRË KATEGORINË E GJYQTARIT NË FGJK

Ekziston një cikël olimpik katër (4) vjeçar që fillon në vitin pas Lojërave Olimpike.
Në përputhje me standardet ndërkombëtare, në vitin e parë të çdo cikli të ri olimpik, FGJK së bashku me komisioni e gjyqtarëve nisin zhvillimin e kurseve të përbashkëta të stërvitjes dhe gjykimit për ekspertët

vendas. Programi i kurseve lokale në gjimnastikë bazohet në rregullat e dhe rekomandimet për të përmbushur kërkesat kombëtare të rregulluara në përputhje me rrethanat. Në përfundim të kurseve të organizuara nga FGJK, të kategoritë e ndryshme mund të jepen ose mund të konfirmohen diploma të dhëna më parë. Në përfundim të kurseve, specialistët që kanë dhënë provimin pajisen me licencën e arbitrit të FGJK-së në bazë të certifikatës së lëshuar nga komisioni i gjyqtarëve. Nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë në këto gara persona që nuk kanë licencë gjyqtari.

Shënim: gjyqtarët me një diplomë ndërkombëtare janë të përjashtuar nga ky proces, pasi ata nuk kanë nevojë të marrin një diplomë gjyqtari vendas.

Artikulli 6.4. ORGANIZIMI I PANELEVE TË GJYQTARISË DHE DETYRIMET NË GARAT ZYRTARE TË FGJK-SË

Garat zyrtare të FGJK-së gjykohen nga gjyqtarët e mëposhtëm:

Artikulli 6.5. KRYEGJYQTARI

Veprimtaria e Kryegjyqtarit përbëhet nga sa vijon:

1. Të mbikëqyrë garën dhe të ndërhyjë në çdo situatë disiplinore ose emergjente që ndikon në rrjedhën e garave.
2. Të marrë masa kur e sheh të nevojshme kur bëhet një gabim i rëndë nga një ose më shumë gjyqtar.
3. Rishikon gjithmonë pikët e dhëna nga gjyqtarët dhe punën e tyre
4. Paralajmëron një gjyqtar kur ka perceptim të njëanshëm, të gjyqtarisë.
5. Diskualifikim dhe zëvendësimi i çdo gjyqtari nëse ndonjë paralajmërim është i pasuksesshëm.
6. Të menaxhojë takimin për gjyqtarët përpara garave.
7. Të mbikëqyrë hedhjen e shortit për përzgjedhjen e gjyqtarëve për gara të ndryshme.
8. Nëse është e nevojshme, të emërohen gjyqtarët me miratimin e BK.
9. Të sigurojë plotësimin e të gjitha kërkesave që lidhen me sjelljen e gjyqtarëve, trajnerëve, gjimnastëve dhe zyrtarëve.

Artikulli 6.6. GJYQTARËT PARA GARAVE ZYRTARE TË FGJK-SË

Në garat zyrtare të FGJK-së, duhet të organizohet një seancë informuese nën drejtimin e kryegjyqtari dhe kryetrajnerit. Qëllimi kryesor është respektimi i Rregullave për llojin përkatës të gjimnastikës dhe konstatimit në ofrimin e një interpretimi të saktë dhe uniform të tabelave të vlerësimit.
Gjyqtarët duhet të marrin pjesë në këtë takim dhe në mbledhjet e mëvonshme. Përndryshe, ata nuk lejohen të kryejnë detyrën e gjyqtarit.
Gjatë këtyre takimeve, kryegjyqatësi ka të drejtë të kontrollojë njohuritë e gjyqtarëve dhe, nëse identifikohen gjyqtar me kompetencë të pamjaftueshme, t'i përjashtojë ata nga garat.

Artikulli 6.7. SJELLJA E GJYQTARËVE DHE KËRKESAVE TË VEÇANTA

Anëtarë të paneleve të gjyqtarëve të FGJK-së për lloje të ndryshme të gjimnastikës, atyre u kërkohet të njihen me rregullat, rregulloren aktuale dhe udhëzimet që zbatohen për një garë të caktuar.

Ata ndjekin disa kode të veshjes, rregullimin e ndenjëseve, udhëzimet e sjelljes etj, disiplina të tjera të përcaktuara në Rregullore për llojet individuale të gjimnastikës dhe ata duhet të ndjekin në mënyrë rigoroze çështjet organizative.

NENI 7.

LLOGARITJA E PIKËVE

Artikulli 7.1. METODAT E PËRCAKTIMIT TË PIKËVE

Metoda e përcaktimit të pikëve dhe e vlerësimit të performancës shpjegohet gjatë trajnimit për llojet individuale dhe ekipore të gjimnastikës. Dihet se gjimnastika ka metodën e veçant të pikësimit/vlerësimi, ku çdo vlerësim bëhet me simbole, dhe keto simbole sjellin pikët.

Artikulli 7.2. PROTOKOLET E REZULTATEVE TË GARAVE

Protokollet e rezultateve të përbëra nga një formë dhe një formë përfundimtare për çdo vegël i dërgohet sekretarit të përgjithshëm.
Rezultatet e të gjitha raundeve të garave, duke përfshirë emrin e secilit gjyqtar dhe detajet e pikëve të dhëna, duhet të dërgohen nga kryegjyqtari në zyrën e FGJK-së brenda tre (3) ditëve pas garës. Protokollet e rezultateve të konkursit duhet të nënshkruhen nga BH.
Rezultatet e përgjithshme të garave duhet publikuar në faqen zyrtare të FGJK-së.

Artikulli 7.3. VLEFSHMËRIA E PIKËVE

Pikët konsiderohen të vlefshme që nga momenti kur konfirmohen nga kryegjyqtari.

Artikulli 7.4. TREGUESIT E REZULTATEVE TË PAVLEFSHME

Disa simbole të veçanta që përdoren për të raportuar rezultatet e pavlefshme:

DNS	**Shenja "NUK FILLOI" (rrjedh nga fjala angleze "Did not start") tregon që atleti nuk e filloi dhe / ose nuk e provoj përformancën. Nëse ata/ato paraqiten dhe nuk përformojnë anjë lëvizje, atëherë atletit nuk i jepen pikë dhe regjistrohet me notë DNS**
DNF	**Shenja "NUK MBAROI" (rrjedh nga fjala angleze "Did not finish") tregon se atleti ka filluar performancën por nuk ka demonstruar lëvizje të mjaftueshme për t'u dhënë një pikë nga gjyqtarët, kjo gjithashtu do të thotë që atleti nuk ka përfunduar një përformancë pas fillimit të ndonjë faze të garës (p.sh. nëse atleti ndalon paraqitjen për shkak të lëndimit).**
"0"	**Zero pikë, janë pikët e dhëna nga gjyqtarët për shkelje të rregulloreve dhe dispozitave të garës.**
DSQ	**"Diskualifikim" (rrjedh nga fjala angleze "Disqualified"), është një shenjë e dhënë në bazë të vendimit të Kryegjyqtarit dhe miratimit të komisionit të gjyqtarëve për shkelje të rëndë teknike të rregullave. "Diskualifikimi" është edhe një shenjë që jepet për rezultate pozitive të dopingut.**

Në raste të caktuara, DNS dhe DNF rezultojnë që atleti të mos kalojë në faza tjera nëse për këtë ka arsye.
Në përputhje me Rregullorat e DSQ për llojet individuale të gjimnastikës dhe nenin 5.4 të kësaj rregullore aktuale, rezulton në sa vijon:

- Rezultatet anulohen dhe hiqen nga ajo fazë e garës;
- Emri i atletit hiqet nga ajo fazë e garës;
- Lista e vlerësimit për atletët për atë fazë të garës përsëri llogaritet;
- Emri i atletit individual të përjashtuar nga ekipi gjatë garës ndërmjet ekipeve hiqet;
- Rezultatet e ekipit dhe vendi në listën e vlerësimit janë të rillogaritura.

NENI 8.

PROTOKOLI

Artikulli 8.1. VËREJTJET E PËRGJITHSHME

Personi përgjegjës për ceremonitë zyrtare të hapjes, mbylljes dhe ndarjes së çmimeve të garave të FGJK-së, dhe garave tjera caktohet nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.
Të gjitha ekipët / altetët duhet të paraqiten në plato, duke mbajtur pllakën me emrin e klubit, shtetit.
Flamuri Shtetëror i Republikës së Kosovës, flamuri i KOK, FIG, dhe klubeve duhet të jenë të vendosura në sallën e garave. Nëse gara është ndërkombëtare flamujt e shteteve pjesëmarrëse do të jenë të vendosura në sallën e garës.
Në hapjen zyrtare të garave dhe mbylljes është e obliguar intonimi i himnit të Republikës së Kosovës.

NENI 9.

ÇMIMET

Artikulli 9.1. PROJEKTIMI I MEDALJEVE DHE DIPLOMAVE

Diplomat në garat zyrtare dhe çmimet e para jepen nga menaxhmenti i FGJK-së. Dizajni i medaljeve dhe i diplomave miratohet nga Bordi Ekzekutiv në bashkëpunim me komisioni e garave.

Artikulli 9.2. KOHA DHE CEREMONIA E NDARJES SË ÇMIMEVE

Komisioni garues është përgjegjës për kryerjen e këtyre ceremonive menjëher pas shpalljes së rezultateve, ku secila kategori merr çmimet e parapara. Në varësi të formatit të diplomave dhe medaljeve, tre (3) atleteve të parë të renditur u jepen çmimet.

Artikulli 9.3. VESHJA GJATË CEREMONISË SË NDARJES SË ÇMIMEVE

Në hapje dhe mbyllje të garës dhe në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të gjithë atletët duhet të jenë me uniformat e tyre sportive.

Nëse nuk respektohet ky rregull atleti përkatës dhe klubi do të ndëshkohen nga Komisioni Disiplinor i FGJK-së.

NENI 10.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Në rastet që nuk parashikohen në këtë Rregullore Teknike,

- Kur shfaqen probleme të papritura gjatë ngjarjeve në shkallë të gjërë,
- Nëse nuk parashikohen në dispozitat e kësaj Rregulloreje,
- Kur është e nevojshme të merrët një vendim i menjëhershëm,

Atëherë zbatohet Statuti i FGJK-së.

Artikulli 10.1. HYRJA NË FUQI E RREGULLORET TEKNIKE TË FGJK-së.

Rregullorja teknike e FGJK-së, është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, në mbledhjen e Kuvendit mbajtur me datë 21/05/2026.

Kryetari i FGJK-së:
Shkumbin Maqastena

Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga